



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

BURSA PËR KURSIN VEROR TË ENERGJISË NË BAKU TË AZERBAJXHANIT

Qendra "Caspian" për Energjinë dhe Mjedisin e Universitetit ADA në Baku të Azerbajxhanit në partneritet me SOCAR, British Petroleum dhe EXXONMOBIL, organizon "*Shkollën Verore të përvitshme të energjisë në Baku*" në datat **08-21 korrik 2018**. Ekspertët më të njohur nga qendrat shkencore të tilla si: Universiteti i Oksfordit, Universiteti Princeton, Akademia Ruse e Shkencave etj., do të organizojnë trajnimet në shkollën verore.

Programi dyjavor në Baku synon të bashkojë studiues me famë botërore, akademikë dhe hartuesit e politikave për të diskutuar mbi çështje të energjisë globale dhe mjedisit, si dhe për zbatimin e tyre në praktikë. Kursi do t'i pajisë konkretisht pjesëmarrësit me njohuritë e nevojshme për energjinë dhe mjedisin, gjeopolitikën e energjisë, ligjin e energjisë dhe të ekonomisë, mënyrën e menaxhimit strategjik në fushën e naftës dhe gazit dhe mbi strategjitë e zhvillimit të SOCAR, etj. Në një fokus të veçantë të programit përfshihen edhe tema për zhvillimin rajonal të rrjetit të tubacionit, gjeopolitikës dhe statusit të saj ligjor së qendrës "Caspian", si dhe një përshkrim strategjik i SOCAR-it.

Përmes një analize të çështjeve energjetike, mjedisore dhe ekonomike, kursi synon identifikimin e mënyrave më të mira për përmirësimin e shfrytëzimit të burimeve të energjisë dhe mjedisit sipas teknologjive të fundit.

Nënvizojmë se për bursat e ofruara për kursin e verës në Azerbajxhan duhet të aplikojnë kryesisht profesionistë nga kompanitë energjetike, politikëbërësit si dhe nëpunësit civilë nga institucionet qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare. Afati i fundit për aplikimin online është data **15 maj 2018**.

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhen: programi i kursit dhe kriteret e aplikimit për pjesëmarrje. Për më shumë informacion referojuni adresave të mëposhtme:

[http://ccee.ada.edu.az/;](http://ccee.ada.edu.az/)

e-mail: ccee@ada.edu.az; summerschool@ada.edu.az

**DREJTORIA E INTEGRIMIT KOORDINIMIT,
MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**